



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA POGRADEC  
KESHILLI

Nr. 1245/prot.

Pogradec, më 24.03 2022

VENDIM  
Nr. 26, DATË 23 / 03 / 2022

PËR

PËR MIRATIMIN E LISTËS TË SIPËRFAQES SË TOKËS PREJ 19.6276 HA, E  
NDODHUR NË NJËSITË ADMINISTRATIVE PROPTISHT, ÇËRRAVË, DARDHAS,  
QË MUND TË JEPEN ME QIRA.

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore", neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 "Për tokat bujqësore të pandara", Udhëzimin nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 "Për shfuqëzimin e udhëzimit nr. 3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave "Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara" me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e sipërfaqes së tokës bujqësore prej 19.6276 Ha ( Nente mbedhjetë pike gjashtemijeedyqind e shtatedhjetegjashte ha), të ndodhur në Njësitë Administrative Proptisht, Çërravë, Dardhas, që mund të jepen me qera sipas listës.

Nr	Pronësia	Zona Kadastrale	Numëri Pasurisë	Vëndodhja Fshati	Lloji Pasurisë	Sipërfaqja në m2
1	Shtet	1387	16	Çërravë	Arë	2400
2	Shtet	1832	23	Grabovicë	Arë	14600
3	Shtet	3046	4	Prenisht	Arë	9276
3	Shtet	3485	103/5	Somotinë	Arë	170000
Σ	<b>TOTALI</b>					<b>196276</b>

2. Toka Bujqësore që do të jepet me qera do të shfrytëzohet vetëm për veprimtari bujqësore.
3. Afati i dhënies me qera do të jetë në përputhje me destinacionin e kultivimit por asnjëherë më i gjatë se afati i përcaktuar pikën IV të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".
4. Çmimi dysheme i vlerës së qerasë nuk do të jete jo më pak se 6000 (gjashtëmije) lekë Ha në vit sipas pikës nr 10 të Udhëzimit nr. 1, datë:18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e dhënies me qera të tokave bujqësore të pandara".
5. Per zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtoria e Burimeve Njerezore dhe Çështjeve Juridike, si dhe Njësitë Administrative Proptisht, Çërravë, Dardhas.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETAR I KËSHILLIT  
Sofiraq MANGËRI

